

British American Tobacco – Albania Shpk

**Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(me raportin e audituesve të pavarur)**

Përmbajtja

	Faqja
Raporti i Audituesve të Pavarur	i-iii
Pasqyrat financiare:	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve të parasë	4
Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare	5-20



KPMG Albania Shpk
Blvd "Dëshmorët e Kombit"
Kullat Binjake Kulla 1, Kati 13
Tiranë, Shqipëri
+355(4)2274 524
al-office@kpmg.com
kpmg.com/al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për pronarin dhe drejtimin e
British American Tobacco – Albania Shpk

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të British American Tobacco – Albania Shpk ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



Përgjegjësitë e Drejtimit në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.



Heris Jani
Auditues Ligjor

KPMG Albania Shpk
Blvd "Dëshmorët e Kombit"
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 30 mars 2018

British American Tobacco – Albania Shpk
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)

	Shënim	2017	2016
Aktive			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	9,289,123	14,305,151
Total i aktiveve afatgjata		9,289,123	14,305,151
Aktive afatshkurtra			
Inventarë	9	200,241,466	199,460,964
Të arkëtueshme tregtare	10	332,030,392	139,187,666
Tatim fitim i parapaguar		-	2,460,311
Aktive të tjera	11	81,004,846	229,390,116
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	12	213,248,974	155,434,878
Totali i aktiveve afatshkurtra		826,525,678	725,933,935
TOTAL I AKTIVEVE		835,814,801	740,239,086
KAPITALI			
Kapitali aksionar	13	552,341,000	552,341,000
Humbjet e mbartura		(141,279,539)	(158,945,804)
TOTAL I KAPITALIT		411,061,461	393,395,196
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Të pagueshme tregtare	14	70,058,218	25,319,836
Tatim fitimi i pagueshëm		8,533,975	-
Detyrime të tjera	15	61,523,436	59,827,189
Provigjione	16	75,789,206	51,608,002
Hua	17	208,848,505	210,088,863
Total i detyrimeve afatshkurtra		424,753,340	346,843,890
TOTAL I DETYRIMEVE		424,753,340	346,843,890
TOTAL I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		835,814,801	740,239,086


Shënimet në faqet 5 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë autorizuar për publikim nga drejtimi i British American Tobacco-Albania Shpk më 30 mars 2018 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Administratore
Menaxhere e Financës

Brunilda Bakiri

Asistent Menaxhere e Financës

Jetmira Cukaj

British American Tobacco – Albania Shpk
Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)

	Shënim	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
		2017	2016
Të ardhurat	18	2,260,973,047	1,750,441,742
Kosto e shitjes	19	(1,904,105,461)	(1,437,979,835)
Fitimi bruto		356,867,586	312,461,907
Shpenzime tregtare dhe marketingu	20	(181,181,077)	(161,293,145)
Shpenzime administrative	21	(172,096,268)	(144,462,152)
Të ardhura të tjera operacionale	22	57,078,251	51,564,393
Rezultati i veprimtarisë operative		60,668,492	58,271,003
Të ardhura financiare		112,278	302,124
Shpenzime financiare		(21,894,324)	(32,531,471)
Të ardhura financiare neto	23	(21,782,046)	(32,229,347)
Fitimi para tatimit		38,886,446	26,041,656
Tatim mbi fitimin	24	(21,220,181)	(8,263,652)
Fitimi për vitin		17,666,265	17,778,004
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		17,666,265	17,778,004

Shënimet në faqet 5 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

British American Tobacco – Albania Shpk
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)

	Kapitali aksionar	Humbje të mbartura	Totali i kapitalit
Më 1 janar 2016	552,341,000	(176,723,808)	375,617,192
Fitimi i vitit	-	17,778,004	17,778,004
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	17,778,004	17,778,004
Më 31 dhjetor 2016	552,341,000	(158,945,804)	393,395,196
Fitimi i vitit	-	17,666,265	17,666,265
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	17,666,265	17,666,265
Më 31 dhjetor 2017	552,341,000	(141,279,539)	411,061,461

Shënimet në faqet 5 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

British American Tobacco – Albania Shpk
Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek)

	Shënim	2017	2016
Flukset e parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit		38,886,446	26,041,656
<i>Rregullime për:</i>			
Shpenzime amortizimi	8	5,754,191	8,301,222
Provigjone neto të krijuara	16	24,181,204	1,830,430
Shpenzime interesi	23	23,903,879	26,343,444
Të ardhura nga interesi	23	(112,278)	(302,124)
Fitime neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	22	(748,000)	(2,271,831)
		91,865,442	59,942,797
Ndryshime në:			
Inventarë		(780,502)	(191,210,301)
Të arkëtueshme tregtare		(192,842,726)	132,474,549
Aktive të tjera		148,385,270	(92,044,540)
Të pagueshme tregtare		44,738,382	18,012,383
Të tjera të pagueshme		1,696,247	21,302,281
Provigjone		-	(2,787,576)
Flukset e parasë nga/(përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit		93,062,113	(54,310,407)
Interes i arkëtuar	23	112,278	302,124
Interes i paguar		(25,144,236)	(27,633,147)
Tatim fitimi i paguar		(10,225,895)	(10,831,530)
Flukset neto të parasë nga/(përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit		57,804,260	(92,472,960)
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	8	(738,163)	(917,327)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		747,999	3,134,714
Flukset neto të parasë gjeneruar nga veprimtaritë investuese		9,836	2,217,387
Flukset e parasë nga veprimtaritë financiare			
Hua të marra	17	-	10,210,000
Flukset neto të parasë gjeneruar nga veprimtaritë financiare		-	10,210,000
Rritja/(ulja) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente me to		57,814,096	(80,045,573)
Mjetet monetare dhe ekuivalente me to më 1 janar		155,434,878	235,480,451
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor	12	213,248,974	155,434,878

Shënimet në faqet 5 – 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

British American Tobacco – Albania Shpk

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

1. Entiteti raportues

British American Tobacco – Albania Shpk (“Shoqëria”) u themelua si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Tiranë më 15 tetor 2001. Shoqëria zotërohet plotësisht nga British American Tobacco International Holdings B.V. e bazuar në Hollandë. Shoqëria mëmë përfundimtare e Shoqërisë është British American Tobacco plc. (ose “Grupi”), e vendosur në Londër, Mbretëria e Bashkuar.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është importi, marketingu dhe shitja me shumicë e cigareve me markën e British American Tobacco, në Shqipëri. Shoqëria operon në kuadër të strategjisë dhe objektivave të Grupit për Shqipërinë dhe rajonin e Ballkanit duke përfshirë Kosovën dhe Maqedoninë. Furnitorët dhe financuesit kryesorë të Shoqërisë janë shoqëri brenda Grupit (shih shënimin 26).

Zyra e regjistruar e Shoqërisë ndodhet në Rrugën e Kavajës, Ish Kombinati Ushqimor, Tiranë, Shqipëri.

Zhvillimet aktuale

Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria kishte humbje të akumuluar prej 141,279,539 Lek (2016: 158,945,804 Lek), kryesisht si rezultat i humbjeve të gjeneruara nga vitet e mëparshme. Gjatë viteve 2017 dhe 2016, Shoqëria ka dalë me fitim, ndërkohë që në 2017 shitjet dhe fitimi neto u rritën krahasuar me 2016 si pasojë e hedhjes në treg të produkteve të reja dhe rritjes së shitjeve për produktet ekzistuese. Shoqëria pret që shitjet të vazhdojnë të rriten në 2018.

Gjatë vitit 2017, Shoqëria ka gjeneruar flukse monetare pozitive nga veprimtaritë e saj të shfrytëzimit në shumën prej 57,804,259 Lek (2016: flukse monetare negative në shumën prej 92,472,960 Lek).

Shoqëria i ka përgatitur këto pasqyra financiare në bazë të parimit të vijimësisë.

2. Bazat e kontabilitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

3. Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

4. Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në lek Shqiptar (“Lek”), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë.

5. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në mënyrë prospektive. Informacioni mbi pasiguritë lidhur me vlerësimet dhe gjykimet të cilat kanë risk të rëndësishëm për të rezultuar në një rregullim material në fund të vitit 31 dhjetor 2017, është përshkruar në shënimet më poshtë:

- Shënimi 7(b)(ii) – zhvlerësimi i të arkëtueshmeve tregtare;
- Shënimi 24 – njohja e aktivitetit të shtyrë tatimor; dhe
- Shënimi 16 – matja e provigjioneve për pasiguri në trajtime fiskale.

6. Përmbledhja e politikave kryesore kontabël

Shoqëria ka zbatuar në mënyrë konsistente politikat kontabël të mëposhtme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

a) Konvertimi i monedhave të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportit. Fitimet ose humbjet nga shlyerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit, njihen në fitim ose humbje.

b) Aktivitetet afatgjata materiale

Aktivitetet afatgjata materiale (pajisjet) mbahen me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë, nëse ka të tilla. Kosto historike përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostot e mëpasshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivitetit afatgjatë material ose njihen si aktiv më vete vetëm nëse është e mundur që Shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin në fjalë dhe kostoja e tij të mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjithë shpenzimet e tjera të mirëmbajtjeve dhe riparimeve njihen në fitim ose humbje në momentin që ato ndodhin.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale njihen neto në zërin ‘Të ardhura të tjera operacionale’ në fitim ose humbje.

Zhvlerësimi përlllogarit për të zvogëluar koston e aktiveve afatgjata materiale minus vlerën e tyre të mbetur, duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së tyre të dobishme, dhe përgjithësisht njihet në fitim ose humbje. Amortizimi fillon të njihet në muajin pas atij të blerjes. Jetët e dobishme të vlerësuara janë si në vijim:

Përshkrimi i kategorisë	Vitet
Pajisje zyre dhe mobilje	5
Pajisje IT	4
Mjete transporti	5

Jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktivitetit rishikohen dhe nëse është e nevojshme, rregullohen në çdo datë raportimi.

c) Inventarët

Inventarët maten me vlerën më të ulët mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarëve llogaritet me metodën FIFO (first-in, first-out) dhe përfshin koston e blerjes, taksa e detyrime të pa rimbursueshme dhe kosto të tjera të kryera për sjelljen e tyre në vendin dhe gjendjen e gatshme për përdorim. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit, minus koston e vlerësuar të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

d) Instrumentet financiarë

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo derivative.

(i) Aktivitetet dhe detyrimet jo derivative financiare – Njohja dhe çregjistrimi

Shoqëria fillimisht njeh huatë dhe të arkëtueshmet në datën kur ato krijohen. Të gjithë aktivitetet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit kur entiteti bëhet pjesë e marrëveshjes kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktiviteti financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivitetit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar. Çdo interes në aktivitetet financiare të transferuara, që kualifikohet për çregjistrim, i mbajtur ose i krijuar nga Shoqëria, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, anuluar apo kanë skaduar.

6. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

d) Instrumentet financiarë (vazhdim)

Aktivet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe synon t'i shlyejë ato në baza neto, ose të njohë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

(ii) Aktive financiare jo derivative - Matja

Huatë dhe të arkëtueshmet maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e drejtpërdrejta të transaksioneve. Pas njohjes fillestare me vlerë të drejtë, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus çdo zhvlerësim (shih politikën kontabël 6 (e)(i)).

(iii) Detyrime financiare jo derivative –Matja

Detyrime të tilla financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë të tregut, plus çdo kosto transaksioni që lidhet drejtpërdrejt me to. Pas njohjes fillestare këto detyrime financiare maten me metodën e koston së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kontabilizimi për fitimet dhe kostot financiare diskutohet në shënimin mbi politikën kontabël 6(k).

e) Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar, i cili nuk regjistrohet me vlerën e drejtë të tregut përmes pasqyrës së të ardhurave, vlerësohet në fund të çdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse ka evidence objektive që tregojnë se mund të jetë i zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidence objektive zhvlerësimi që tregojnë se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivit financiar dhe kjo mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijë pamundësi apo vështirësi të një klienti për të realizuar pagesën, ristrukturim të një detyrimi ndaj Shoqërisë me kushte që Shoqëria nuk do të hynte në raste të tjera, ose treguese që një klient do të shpallë falimentin.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar. Aktivet financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim në bazë individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohen në grupe që ndajnë të njëjtat karakteristika të riskut të kredisë. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Një humbje nga zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Anulimi apo pakësimi i zhvlerësimit njihet në fitim ose humbje.

(ii) Aktivet jo financiare

Vlerat e mbartura të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Nëse ka evidencë të tillë, atëherë vlera e rikuperueshme e aktivit vlerësohet.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot për t'u shitur. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontohen për të dhënë vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivit. Me qëllim testimin për zhvlerësim, aktivet grupohen së bashku në njësinë më të vogël të aktiveve që gjenerojnë flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vazhdueshëm që janë të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve të tjera apo grupeve të tjera të aktiveve ("njësi gjeneruese e mjeteve monetare").

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e një aktivi ose e një njësie gjeneruese të mjeteve monetare e tejkalon shumë e rikuperueshme të vlerësuar. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me një njësi gjeneruese të mjeteve monetare shpërndahen për të zvogëluar vlerën e mbartur të aktiveve në njësi (grup njësisish) në varësi të peshës së secilit. Humbja nga zhvlerësimi rishikohet në çdo datë raportimi për tregues që humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi kthehet nëse ka patur një ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar vlerën e realizueshme. Humbja nga zhvlerësimi kthehet vetëm në masën në të cilën vlera e mbartur e aktivit nuk tejkalon vlerën e mbetur të tij, që përcaktohet nga vlera neto e tij pas amortizimit, nëse nuk ka humbje nga zhvlerësimi.

6. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

f) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

g) Provizionet

Një provizion njihet kur Shoqëria, si pasojë e ngjarjeve të shkuara ka një detyrim aktual, ligjor ose strukturor, që mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të kërket një fluks dalës të mirash ekonomike për të shlyer detyrimin. Provizionet llogariten duke skontuar fluksat e ardhshme monetare me një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasas dhe rreziqet specifike të detyrimit. Amortizimi kohor i skontimit njihet si kosto financiare.

h) Të ardhurat

(i) Shitja e mallrave

Të ardhurat njihen nëse rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme të lidhura me pronësinë janë transferuar tek blerësi, arkëtimi i shumave është më i mundshëm të ndodhë sesa jo; kostot shoqëruese dhe kthimi i mundshëm i mallrave mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të vazhdueshme menaxheriale në lidhje me mallrat, dhe shumat e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme. Të ardhurat maten duke i pakësuar për kthimet, zbritjet tregtare dhe zbritjet nga volumi. Transferimi i rreziqeve dhe përfitimeve zakonisht ndodh kur produkti arrin në magazinën e klientit.

(ii) Shërbimet

Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen në fitim ose humbje në përpjesëtim me fazën e përfundimit të transaksionit në datën e raportimit.

i) Përfitimet e punonjësve

Skemë me kontribute të përcaktuara

Shoqëria paguan kontribute fikse për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve të saj mbi daljen në pension. Detyrimet për kontribute në skemat e pensioneve me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet, në bazë të një plani kontributësh të përcaktuara.

Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punonjësve vlerësohen të paskontuara dhe njihen si shpenzim kur shërbimi përkatës kryhet. Një detyrim njihet për shumën që pritet të paguhet sipas përfitimeve afatshkurtra apo planeve për ndarjen e fitimit, nëse Shoqëria ka një detyrim ligjor apo strukturor për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara, të kryera nga punonjësi dhe detyrimi mund të vlerësohet me besueshmëri.

j) Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qira operative njihen në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Stimujt e marrë për qiranë njihen si pjesë integrale e pagesës totale të qirasë përgjatë kohëzgjatjes së saj.

k) Të ardhurat dhe kostot financiare

Të ardhurat financiare dhe kostot financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi, shpenzimet e interesit dhe fitimet ose humbjet nga veprimet në monedhë të huaj. Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi në monedha të huaja paraqiten për shumën neto.

6. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

l) Tatimi mbi të ardhurat

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveçse kur lidhen me elementë që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

(i) Tatim fitim aktual

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose për t'u arkëtuar nga të ardhurat e tatueshme ose humbja për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose thelbësisht në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullimi të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerat e përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar.

Aktivet për tatime të shtyra njihen vetëm deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Tatimi i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor të realizohet.

Aktivet dhe detyrimet e shtyra tatimore paraqiten neto, në qoftë se ka një të drejtë ligjore për të netuar aktivet dhe detyrimet aktuale tatimore, dhe ato lidhen me tatime mbi të ardhurat të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor, për të njëjtin subjekt tatimor, ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por ata kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivet aktuale tatimore në bazë neto, ose aktivet dhe detyrimet tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Në përcaktimin e vlerës së tatim fitimit aktual dhe të shtyrë Shoqëria merr parasysh impaktin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse taksa dhe interesa shtesë mund të jenë të pagueshme. Shoqëria beson se përlllogaritjet për detyrime tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet, bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretime të ligjit të taksave dhe eksperiencës së mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në llogaritje dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacion i ri mund të jetë në dispozicion dhe mund të shkaktojë që Shoqëria të ndryshojë gjykimet në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të kenë impakt mbi tatim fitimin në periudhat që ky përcaktim bëhet.

m) Standardet dhe interpretimet e reja, ende të pazbatuara

Disa standarde të reja dhe ndryshime në standardet e interpretimet ekzistuese nuk janë ende të detyrueshme për zbatim për periudhat vjetore që fillojnë më datë 1 janar 2017, dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara. Shoqëria planifikon t'i zbatojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

SNRF 15 Të Ardhura nga Kontratat me Klientët

SNRF 15 hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas datës 1 janar 2018, duke lejuar dhe zbatimin më të hershëm. Standardi i ri zëvendëson udhëzimet ekzistuese për njohjen e të ardhurave sipas SNRF, duke përfshirë SNK 18 *Të ardhurat*, SNK 11 *Kontratat e Ndërtimit* dhe KIRFN 13 *Programet e Besnikërisë së Klientit*. Shoqëritë do të zbatojnë një model me pesë hapa për të përcaktuar kur duhet njohur e ardhura dhe në çfarë shume. Modeli i ri saktëson që e ardhura duhet të njihet kur (ose ndërkohë që) një njësi ekonomike transferon kontrollin mbi mallrat ose shërbimet tek një klient për shumën të cilën njësi ekonomike pret të ketë të drejtën të arkëtojë. Në varësi të përmbushjes së disa kriterëve, e ardhura njihet:

- përgjatë periudhës, në një mënyrë që pasqyron ecurinë e njësisë ekonomike; ose
- në një moment kohor, kur kontrolli mbi mallrat ose shërbimet i transferohet klientit.

SNRF 15 gjithashtu vendos parimet që një njësi ekonomike duhet të zbatojë për dhënien e shënimeve shpjeguese cilësore dhe sasiore që japin informacion të dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare mbi natyrën, shumën, kohën dhe pasigurinë në lidhje me të ardhurat si dhe mbi flukset monetare nga kontratat me klientët.

6. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

m) Standardet dhe interpretimet e reja, ende të pazbatuara (vazhdim)

Megjithëse ende nuk ka përfunduar vlerësimin e tij fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 15 mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë, drejtimi nuk pret që Standardi i ri, në momentin e zbatimit fillestar të tij, të ketë ndonjë ndikim material mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë. Koha dhe matja e të ardhurave të Shoqërisë nuk pritet të ndryshojnë me SNRF 15 për shkak të natyrës së veprimtarive të Shoqërisë dhe llojit të të ardhurave që ajo realizon.

SNRF 9 Instrumentet Financiare

SNRF 9, publikuar në korrik 2014, zëvendëson udhëzimet ekzistuese në SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja. SNRF 9 paraqet udhëzime të rishikuara mbi klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, duke përfshirë një model të ri të humbjeve të pritshme të kredisë për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kritere të përgjithshme të reja për kontabilitetin mbrojtës. SNRF 9 hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas datës 1 janar 2018, duke lejuar dhe zbatimin më të hershëm. Shoqëria nuk pret që Standardi i ri, në momentin e zbatimit fillestar të tij të ketë ndonjë ndikim material mbi pasqyrat financiare të konsoliduara.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 zëvendëson udhëzimet ekzistuese për qiratë, duke përfshirë SNK 17 *Qiratë*, KIRFN 4 *Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira*, KIS-15 *Qiratë Operative - Stimujt* dhe KIS-27 *Vlerësimi i Përmbajtjes së Transaksioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të një Qiraje*. Standardi i ri sjell një model të vetëm kontabël të paraqitjes në bilanc të qirave nga qiramarrësit. Një qiramarrës njih një aktiv për të drejtën e përdorimit që përfaqëson të drejtën e tij të përdorimit të aktivitet bazë dhe një detyrim qiraje që përfaqëson detyrimin e tij për të bërë pagesa qiraje. Ka përjashtime nga njohja për qiratë afat-shkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët. Kontabiliteti nga qiradhënësi mbetet i ngjashëm me standardin aktual – pra, qiradhënësit do të vazhdojnë të klasifikojnë qiratë si financiare ose operative. Standardi hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 duke lejuar edhe zbatim më të hershëm për njësitë ekonomike që zbatojnë SNRF 15 në ose para datës së zbatimit fillestar të SNRF 16.

Shoqëria ka kryer një vlerësim fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 16 mbi pasqyrat financiare, por nuk ka kryer ende një vlerësim të detajuar. Ndikimi aktual i zbatimit të SNRF 16 mbi pasqyrat financiare në periudhën e zbatimit fillestar do të varet nga kushtet e ardhshme ekonomike, duke përfshirë normën e huamarrjes së Shoqërisë më 1 janar 2019, përbërjen e portofolit të qirave së Shoqërisë në atë datë, vlerësimin më të fundit të Shoqërisë nëse do të ushtrrojë ndonjë nga mundësitë e rinovimit të qirave si dhe shkallën në të cilën Shoqëria do të zgjedhë të përdorë lehtësitë praktike dhe përjashtimet nga njohja.

Deri më tani, ndikimi më i rëndësishëm i identifikuar është se Shoqëria do të njohë aktive dhe detyrime të reja për qiratë e saj operative të ambienteve të magazinës. Më 31 dhjetor 2017, pagesat e paaktualizuara minimale të ardhshme të qirasë operative, të paanulueshme janë 4,998,920 mijë Lek (shih Shënimin 25).

Për më tepër, natyra e shpenzimeve që lidhen me ato qira do të ndryshojë tashmë pasi SNRF 16 zëvendëson shpenzimet e njëtrajtshme të qirasë me shpenzimin e amortizimit të së drejtës së përdorimit të aktiveve me qira dhe shpenzimin e interesit mbi detyrimet e qirasë. Nuk pritet ndonjë ndikim i rëndësishëm për qiratë financiare të Shoqërisë.

6. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

m) Standardet dhe interpretimet e reja, ende të pazbatuara (vazhdim)

Standarde dhe interpretime të tjera

Ndryshimet e mëposhtme në standarde dhe interpretime nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë.

- Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2014-2016 - Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28
- Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione (Ndryshime në SNRF 2).
- Transferimi i aktiveve materiale afatgjata të investuara (Ndryshime në SNK 40)
- Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarrjes së Përbashkët përkatëse (Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28)
- KIRFN 22 Transaksionet dhe Paradhëniet në Monedhë të Huaj
- KIRFN 23 Pasiguritë mbi Trajtimet e Tatimit mbi Fitimin
- Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNRF 9)
- Interesat Afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28)
- Përmirësimet vjetore të SNRF Periudha 2015-2017 - Ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12, SNK 23
- Ndryshimet, Shkurtimeve ose Shlyerjet e Planit të Pensioneve (Ndryshimet në SNK 19).

7. Instrumentet financiare – vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut

(a) Vlera e drejtë

Disa nga politikat kontabël të Shoqërisë dhe notave shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime matjeje dhe/ose prezantimi bazuar në metodat në vijim. Ku është e aplikueshme, është prezantuar informacioni mëtejshëm rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë në notat shpjeguese specifike të aktiveve dhe detyrimeve.

Aktivet financiare jo derivative

Llogaritë e arkëtueshme tregtare paraqiten neto nga zhvlerësimi. Llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë kanë një vlerë të drejtë e cila përafrohet me vlerën e tyre të mbetur për shkak të natyrës afatshkurtër të tyre.

Detyrime financiare jo-derivative

Vlera e drejtë, e cila është përcaktuar për qëllime prezantimi, është llogaritur bazuar në vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme nga principlali dhe interesi, të aktualizuara me normën e tregut të interesit në datën e raportimit. Vlera kontabël e huave dhe detyrimeve të tjera përafrohet me vlerën e tyre të drejtë për shkak të afatit të tyre të shkurtër të maturimit.

(b) Administrimi i rrezikut financiar

Administrimi i rrezikut financiar është element thelbësor në aktivitetin e Shoqërisë. Rreziqet më të mëdha ndaj të cilave Shoqëria është e ekspozuar janë si në vijim:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit; dhe
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe administrimin e rrezikut dhe administrimin e kapitalit.

(i) Kuadri i administrimit të rrezikut

7. Politikat e administrimit të rrezikut të Shoqërisë kanë për qëllim të identifikojnë, analizojnë dhe menaxhojnë rrezikun me të cilin përballet Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e duhura për rreziqet, dhe monitoruar vazhdimisht nivelet e rrezikut dhe përputhshmërinë me limitet. Politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara dhe dhe praktikatat më të mira në zhvillim.

British American Tobacco – Albania Shpk

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

7. Instrumentet financiare – vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)

(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(i) Kuadri i administrimit të rrezikut

Drejtimi i Shoqërisë në bashkëpunim me strukturat e administrimit të rrezikut të grupit dhe të mbikëqyrur nga grupi, ka përgjegjësi mbi problemet e strukturës së administrimit të rrezikut, duke mbikëqyrur administrimin e rreziqeve kryesore, duke rishikuar politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut si dhe duke aprovuar transaksionet që përfshijnë shumata të rëndësishme.

Funksioni i administrimit të rrezikut i referohet rrezikut financiar, rrezikut operacional dhe rrezikut ligjor.

Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera të çmimeve), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit. Objektivat kryesore të administrimit të rrezikut financiar janë përcaktimi i limiteve të rrezikut, dhe të sigurojë që ekspozimi ndaj rreziqeve të jetë brenda këtyre limiteve. Rreziku i administrimit operacional dhe ai ligjor synojnë të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme, për të minimizuar rreziqet operationale dhe ligjore.

Faktorët e rrezikut të jashtëm dhe të brendshëm identifikohen dhe menaxhohen përmes strukturës organizative të Shoqërisë dhe veçanërisht nga strukturat e administrimit të rrezikut në nivel grupi.

(ii) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e saj kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë. Klienti i vetëm i Shoqërisë (“Klienti”), është një shoqëri vendase e shitjes me shumicë. Ekspozimi i Shoqërisë kundrejt rrezikut të kredisë ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të Klientit të saj.

Pas datës së raportimit, Shoqëria ka arkëtuar të gjithë shumën e mbetur të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe për këtë arsye nuk pret ndonjë humbje nga mospagimi. Klienti ka ofruar një garanci bankare prej 1,000,000 Euro, e vlefshme deri më 29 dhjetor 2018, për të garantuar të arkëtueshmet. Sipas kontratës midis palëve, kjo garanci do të jetë në fuqi përgjatë gjithë periudhës së kontratës. Gjithashtu, të arkëtueshmet e mbetura janë mbuluar me barrë siguruese në favor të Shoqërisë mbi inventarin e cigareve të mbajtur nga Klienti. Më 31 dhjetor 2017, stoku i cigareve i mbajtur nga Klienti, i matur me çmimin e shitjes, të faturuar nga Shoqëria, është 177,852 mijë Lek (2016: 71,389 mijë Lek).

Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë reflektohet në vlerën kontabël të aktiveve.

	2017	2016
Të arkëtueshme tregtare	332,030,392	139,187,666
Të arkëtueshme të tjera (Shënimi 11)	14,424,283	46,216,852
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	213,248,974	155,434,878
	559,703,649	340,839,396

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, analiza e vjetërsisë së të arkëtueshmeve është si në vijim:

	2017	2016
Pa vonesë dhe jo të zhvlerësuara	332,030,392	139,187,666
Në vonesë më shumë se një vit	34,791,575	34,791,575
Zbritje për zhvlerësim	(34,791,575)	(34,791,575)
	332,030,392	139,187,666

Nuk ka lëvizje në provizionet e zhvlerësimit lidhur me llogaritë e arkëtueshme gjatë vitit 2017 dhe 2016. Shumat e zhvlerësuara lidhen më mallra të dëmtuara të furnizuara tek Klienti. Palët po ndjekin procedurat e nevojshme për shkatërrimin e këtyre mallrave në mënyrë që të rikuperojnë akcizën e paguar në fillim nga Shoqëria për këto mallra.

British American Tobacco – Albania Shpk**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***7. Instrumentet financiare – vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)****(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)***(iii) Rreziku i likuiditetit*

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Përjasja e Shoqërisë për të menaxhuar likuiditetin është të sigurojë, sa më shumë që të jetë e mundur, që do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj kur ato maturohen, në kushte normale dhe të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme ose rrezikuar reputacionin e saj.

Zakonisht Shoqëria sigurohet se ka likuiditet të mjaftueshëm për të përballuar shpenzimet e pritshme operationale, duke përfshirë shlyerjen e detyrimeve financiare; kjo përjashton ndikimin potencial të rrethanave ekstreme që nuk mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, të tilla si katastrofat natyrore.

Struktura e maturitetit të detyrimeve financiare të Shoqërisë në bazën e pagesave kontraktuale të paskontuara është prezantuar si më poshtë:

	Më pak se 3 muaj	Midis 3 muaj dhe 1 vit	Totali
31 dhjetor 2017			
Detyrimet financiare			
Huatë	-	208,848,505	208,848,505
Të pagueshme tregtare	70,058,218	-	70,058,218
Të pagueshme ndaj personelit dhe shpenzime të llogaritura (shënimi 15)	59,433,340	-	59,433,340
Totali i detyrimeve financiare	129,491,558	208,848,505	338,340,063

	Më pak se 3 muaj	Midis 3 muaj dhe 1 vit	Totali
31 dhjetor 2016			
Detyrimet financiare			
Huatë	-	210,088,863	210,088,863
Të pagueshme tregtare	25,319,836	-	25,319,836
Të pagueshme ndaj personelit dhe shpenzime të llogaritura (shënimi 15)	50,617,356	-	50,617,356
Totali i detyrimeve financiare	75,937,192	210,088,863	286,026,055

(iv) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që lëvizjet në çmimet e tregut, duke përfshirë edhe kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë. Rreziku i tregut përfshin rrezikun e monedhës dhe rrezikun e normës së interesit, meqenëse Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj instrumenteve të kapitalit dhe rreziqeve të lidhura me to. Rreziku i tregut rrjedh nga pozicionet e hapura në normat e interesit dhe në monedhë të huaj që janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve specifike dhe të përgjithshme të tregut dhe ndryshimit të nivelit të paqëndrueshmërisë së çmimeve të tregut. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe të kontrollojë ekspozimet e rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Rreziku i monedhës

Shoqëria ka aktive dhe detyrime të shprehura në Euro. Rreziku i monedhës së huaj lind kur aktivet aktuale ose të parashikuara në një monedhë të huaj janë ose më të mëdha, ose më të vogla se detyrimet në këtë monedhë. Ndikimi i rrezikut të normës së këmbimit valutor mbi Shoqërinë është kufizuar edhe pasi të gjitha transaksionet janë në Lek dhe Euro. Kurset më të rëndësishme të këmbimit kanë qenë si më poshtë:

	2017	2016
Kursi i këmbimit në fund të vitit (1 Euro)	132.95	135.23
Kursi mesatar i këmbimit (1 Euro)	134.15	137.37

British American Tobacco – Albania Shpk**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***7. Instrumentet financiare – vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)****(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)***(iv) Rreziku i tregut (vazhdim)**Rreziku i monedhës (vazhdim)*

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të monedhës së huaj bazuar në shuma nominale është si në vijim:

31 dhjetor 2017	Euro	GBP
Aktivitet financiar		
Të arkëtueshme të tjera	2,435,921	-
Mjete monetare edhe ekuivalente me to	2,995,062	-
	5,430,983	-
Detyrimet financiare		
Të pagueshme tregtare	50,320,034	6,502,307
	50,320,034	6,502,307
Pozicioni financiar neto	(44,889,051)	(6,502,307)
31 dhjetor 2016	Euro	GBP
Aktivitet financiar		
Të arkëtueshme të tjera	2,258,223	-
Mjete monetare edhe ekuivalente me to	5,740,584	-
	7,998,807	-
Detyrimet financiare		
Të pagueshme tregtare	11,912,031	3,104,101
	11,912,031	3,104,101
Pozicioni financiar neto	(3,913,224)	(3,104,101)

Një rritje/(ulje) e arsyeshme me 1% në kursin e këmbimit të Lek-ut përkundrejt Euro-s deri më 31 dhjetor 2017 do të kishte ndikim në fitim ose humbje para tatimit me 448,891 Lek (2016: 39,132 Lek). Një rritje/(ulje) e arsyeshme me 1% në kursin e këmbimit të Lek-ut përkundrejt GBP-së deri më 31 Dhjetor 2017 do të kishte ndikim në fitim ose humbje para tatimit me 65,023 Lek (2016: 31,041 Lek).

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që lëvizjet në normat e interesit do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose në vlerën e portofolit të instrumenteve financiarë. Duke qenë se Shoqëria nuk ka aktive që mbartin rrezik të rëndësishëm, të ardhurat e Shoqërisë dhe flukset operative janë kryesisht të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut. Ndryshimet në normat e interesit ndikojnë kryesisht në huamarrjet me normë interesi fikse, duke ndryshuar vlerën e tyre të drejtë. Drejtimi nuk ka një politikë formale që përcakton se sa huamarrje duhet të jenë me normë interesi fikse apo variabël. Megjithatë, kur merren hua të reja drejtimi përdor gjykimin e tij për të vendosur nëse beson se një normë interesi fikse ose variabël do të jetë më e përshtatshme për Shoqërinë gjatë periudhës së pritshme deri në maturim.

Profili i normës së interesit që mban Shoqëria për instrumentet financiare në datën e raportimit ishte si më poshtë:

	Vlera e mbetur më 31 dhjetor	
	2017	2016
Huatë (normat e ndryshueshme)	208,848,505	210,088,863
	208,848,505	210,088,863

Më 31 dhjetor 2017, një rritje (rënie) e mundshme e arsyeshme me 100 pikë bazë në normat e interesit, me të gjithë faktorët e tjerë të mbajtur të pandryshuar, do të kishte një rënie (ritje) të kapitalit dhe fitimit ose humbjes para tatimit me 2,088,485 Lek (2016: 2,100,889 Lek).

British American Tobacco – Albania Shpk**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***7. Instrumentet financiare – vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)****(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)***(v) Administrimi i kapitalit*

Objektivat e Shoqërisë në administrimin e kapitalit janë ruajtja e aftësisë së Shoqërisë sipas parimit të vijimësisë në mënyrë që të sigurojë një fitim për pronarët dhe të mbajë një strukturë optimale të kapitalit për të ulur koston e tij. Kapitali total llogaritet si pjesa e kapitalit të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar plus borxhin neto. Borxhi neto llogaritet si totali i huave paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar minus mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre. Për të ruajtur apo përshtatur strukturën e kapitalit, Grupi mund të përshtatë sasinë e dividendit të paguar aksionarëve ose mund të nxjerrë aksione të reja apo të shesë aksione për të zvogëluar borxhet.

Shoqëria është financuar me kapital dhe kryesisht me financime nga palët e lidhura. Politikat e aplikuara synojnë që Shoqëria të jetë në gjendje të paguajë borxhet dhe detyrimet në lidhje me shpenzimet në investimet kapitale kur ato maturohen.

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë kërkesë të jashtme lidhur me kapitalin.

8. Aktivet e afatgjata materiale

	Pajisje zyre dhe mobilje	Pajisje IT	Mjete transporti	Totali
<i>Kosto</i>				
Më 1 janar 2016	9,692,528	18,598,322	65,263,648	93,554,498
Shtesa	-	917,327	-	917,327
Pakësime	-	-	(27,921,078)	(27,921,078)
Më 31 dhjetor 2016	9,692,528	19,515,649	37,342,570	66,550,747
Shtesa	-	738,163	-	738,163
Pakësime	-	-	(5,455,262)	(5,455,262)
Më 31 dhjetor 2017	9,692,528	20,253,812	31,887,308	61,833,648
<i>Amortizimi i akumuluar</i>				
Më 1 janar 2016	(8,345,119)	(16,117,672)	(46,539,778)	(71,002,569)
Shpenzime të vitit	(239,272)	(2,087,020)	(5,974,930)	(8,301,222)
Pakësime	-	-	27,058,195	27,058,195
Më 31 dhjetor 2016	(8,584,391)	(18,204,692)	(25,456,513)	(52,245,596)
Shpenzime të vitit	(202,379)	(1,139,858)	(4,411,954)	(5,754,191)
Pakësime	-	-	5,455,262	5,455,262
Më 31 dhjetor 2017	(8,786,770)	(19,344,550)	(24,413,205)	(52,544,525)
<i>Vlera kontabël neto</i>				
Më 31 dhjetor 2016	1,108,137	1,310,957	11,886,057	14,305,151
Më 31 dhjetor 2017	905,758	909,262	7,474,103	9,289,123

Shpenzimet e amortizimit janë përfshirë në shpenzimet tregtare dhe të marketingut si dhe në shpenzimet administrative në fitim ose humbje.

9. Inventarët

	2017	2016
Mallra të gatshëm	181,993,717	192,463,645
Pulla fiskale të akcizës	18,247,749	6,997,319
	200,241,466	199,460,964

Më 31 dhjetor 2017, mallrat e gatshëm prej 181,993,717 Lek (2016: 192,463,645 Lek) përfshijnë cigare të importuara. Pas vendimit të Shoqërisë për të operuar me magazinën e saj që nga korriku 2016, mallrat e importuara të cilat më parë i shiteshin Klientit menjëherë pasi importoheshin, mbaheshin lokalisht si inventarë.

British American Tobacco – Albania Shpk**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***10. Të arkëtueshme tregtare**

	2017	2016
Llogari tregtare të arkëtueshme	366,821,967	173,979,241
Zbritja - fondi i zhvlerësimit	(34,791,575)	(34,791,575)
	<u>332,030,392</u>	<u>139,187,666</u>

Të arkëtueshmet tregtare përfshijnë shumat e arkëtueshme nga THG për shitjen e cigareve. Shih shënimin 7(b)(ii) për më shumë detaje lidhur me llogaritë e arkëtueshme dhe administrimin e rrezikut të kredisë. Rritja e të arkëtueshmeve tregtare më 31 dhjetor 2017 në krahasim me 31 dhjetor 2016, është shkaktuar nga rritja e shitjeve dhe kushteve të kredisë nga 40 ditë në 50 ditë.

11. Aktive të tjera

	2017	2016
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura (Shënimi 26)	14,424,283	46,216,852
Aktivet financiare	<u>14,424,283</u>	<u>46,216,852</u>
Parapagime për akcizën dhe detyrime doganore	59,317,750	150,199,381
Parapagime për TVSH-në	6,398,286	31,979,355
Parapagime të tjera	864,527	994,528
Aktive jo-financiare	<u>66,580,563</u>	<u>183,173,264</u>
	<u>81,004,846</u>	<u>229,390,116</u>

Parapagimet e akcizës dhe detyrimeve doganore më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përfshijnë shumën të parapaguara autoriteteve doganore për blerjen e mallrave gjatë dy muajve të parë të vitit 2018.

Parapagimet e TVSH-së më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, lidhen kryesisht me blerjen e mallrave të gatshëm (shih shënimin 9)

12. Mjete monetare edhe Ekuivalente me to

	2017	2016
Llogari rrjedhëse me bankat		
– Në Lek	210,253,912	149,694,294
– Në Euro	2,995,062	5,740,584
	<u>213,248,974</u>	<u>155,434,878</u>

Shoqëria ka llogari rrjedhëse në Societe Generale Albania. Më 31 dhjetor 2017, llogaritë rrjedhëse kanë një normë interesi prej 0.01% në vit në Lek dhe në Euro (2016: 0.05% në vit në Lek dhe në Euro).

13. Kapitali aksionar

	Kapitali aksionar		
	Pronësia	2017	2016
British American Tobacco International Holdings B.V.	100%	552,341,000	552,341,000

Më 31 dhjetor 2017, kapitali aksionar i Shoqërisë është 552,341,000 Lek (2016: 552,341,000 Lek) dhe është i ndarë në 552,341 aksione me vlerë nominale 1,000 Lek secili. Kapitali është plotësisht i paguar.

14. Të pagueshme tregtare

	2017	2016
Tobacco Holdings Group Shpk	6,741,326	6,059,254
Furnitorë ose shërbime	13,650,600	4,735,884
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura (Shënimi 26)	49,666,292	14,524,698
	<u>70,058,218</u>	<u>25,319,836</u>

British American Tobacco – Albania Shpk**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***15. Detyrime të tjera**

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Të pagueshme ndaj personelit	9,865,337	17,457,049
Detyrime të shtyra për incentiva tregtare	42,009,500	29,354,957
Taksa të tjera të pagueshme përveç tatimit në fitim	2,090,096	9,209,833
Detyrime të tjera të përlllogaritura	7,558,503	3,805,350
	<u>61,523,436</u>	<u>59,827,189</u>

16. Provizionet

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Gjendja më 1 janar	51,608,002	52,565,148
Provizionet neto të njohura gjatë vitit	24,181,204	1,830,430
Provizione të përdorura gjatë vitit	-	(2,787,576)
Balanca më 31 dhjetor	<u>75,789,206</u>	<u>51,608,002</u>

Provizionet lidhen me detyrime të mundshme për taksa të ndryshme të vlerësuara nga drejtimi. Vlerësimet bazohen në interpretimet e legjisllacionit tatimor, si dhe mbi vendime gjyqësore e të tjera në lidhje me to.

17. Huatë

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Huatë	208,848,505	210,088,863
	<u>208,848,505</u>	<u>210,088,863</u>

Shoqëria ka një linjë kredie me BAT WECT me maturim më 1 qershor 2018, me një limit prej 500,000 mijë Lek dhe një normë interesi të ndryshueshme prej 3M Bono Thesari Shqiptare + 1.2 % në vit. Një tarifë angazhimi prej 0.42% në vit është e pagueshme mbi shumën e patërhequr. Më 31 dhjetor 2017 norma e interesit të huasë është 4.78 % në vit (2016: 6.64% në vit).

18. Të ardhurat

Sipas ligjit dhe udhëzimeve në fuqi mbi TVSH-në, shitjet e cigareve janë faturuar nga Shoqëria tek Klienti me çmimin përfundimtar të publikuar të shitjes me pakicë, minus çdo komision të ndërmjetëm tregtar, siç janë komisionet e shitjes me shumicë dhe pakicë. Shumat totale të faturuara janë si më poshtë:

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Çmimi i publikuar i shitjes me pakicë	2,681,454,830	2,057,169,581
Minus: zbritjet tregtare	(420,481,783)	(306,727,839)
Të ardhurat nga shitjet	<u>2,260,973,047</u>	<u>1,750,441,742</u>

19. Kosto e shitjes

Kosto e shitjes përbëhet nga:

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Shpenzime të blerjes së cigareve	291,695,028	201,688,735
Akciza	1,500,627,700	1,150,174,300
Shpenzime edhe detyrime të tjera	111,782,733	86,116,800
	<u>1,904,105,461</u>	<u>1,437,979,835</u>

British American Tobacco – Albania Shpk**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***20. Shpenzime tregtare dhe marketingu**

Shpenzimet sipas natyrës janë prezantuar si më poshtë:

	2017	2016
Shpenzime për tregtimin dhe mbështetjen e markës	140,247,102	112,701,095
Shpenzime personeli	24,711,601	26,823,146
Shërbime të jashtme	3,424,573	5,048,792
Shpenzime utilitare, qira dhe të konsumueshme të tjera	5,839,259	4,732,616
Amortizimi	3,259,845	4,087,842
Shpenzime për dieta dhe udhëtime	2,714,743	3,291,050
Të tjera	983,954	4,608,604
	181,181,077	161,293,145

21. Shpenzime administrative

Shpenzimet sipas natyrës janë të prezantuara si më poshtë:

	2017	2016
Shpenzime për teknologjinë e informacionit (TI)	59,171,761	55,732,611
Shërbime profesionale	22,674,870	17,142,180
Shpenzime personeli	19,646,730	29,147,408
Shpenzime për provizione (Shënimi 16)	24,181,204	1,830,430
Shërbime të jashtme	6,677,183	5,123,423
Shpenzime konsulence, ligjore dhe trajnimi	8,032,817	6,955,327
Qira	6,201,697	6,722,848
Udhëtime dhe aktivitete	5,178,995	6,650,207
Shpenzime utilitare dhe të konsumueshme të tjera	2,909,711	6,203,550
Amortizimi	2,494,346	3,846,445
Riparime dhe mirëmbajtje	1,662,843	1,323,865
Shpenzime të tjera	13,264,111	3,783,858
	172,096,268	144,462,152

Shpenzimet profesionale janë për shërbime financiare dhe ekzekutive të ofruara nga palë të lidhura dhe ato për TI lidhen kryesisht me implementimin e një sistemi me bazë SAP-in për planifikimin e burimeve të ndërmarrjes, të integruar me të gjitha entitetet e BAT.

Në tabelën në vijim janë paraqitur shumat totale të shpenzimeve për kompensimin e punonjësve, të përfshira në shpenzimet e tregtare dhe të marketingut dhe shpenzimet administrative:

	2017	2016
Pagat	29,038,699	34,330,792
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	2,748,609	2,909,976
Shpërblime	6,214,340	14,252,091
Të tjera	6,356,683	4,477,695
Totali	44,358,331	55,970,554

Deri më 31 dhjetor 2017, Shoqëria ka punësuar 15 punonjës (31 dhjetor 2016: 12 punonjës).

22. Të ardhura të tjera operative

	2017	2016
Fitimi neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	748,000	2,271,831
Të ardhura nga shërbimet e rimbursuara (Shënimi 26)	43,066,140	49,292,562
Rimarrja e detyrimeve të përlllogaritura të periudhave të shkuara	13,264,111	-
	57,078,251	51,564,393

Gjatë vitit 2017, të ardhurat nga shërbimet e rimbursuara përbëhen nga shërbime të mbështetjes menaxheriale dhe shërbime të tjera lidhur me shpërndarjen, marketingun dhe shitjen e produkteve të BAT në Kosovë, Maqedoni dhe Serbi.

British American Tobacco – Albania Shpk**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***23. Shpenzimet financiare neto**

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Fitime financiare		
Interesi i përfituar nga depozitat	112,278	302,124
	112,278	302,124
Kosto financiare		
Humbje nga kursi i këmbimit, neto	2,009,555	(6,188,027)
Pagesa për garanci bankare	(7,566,000)	(4,847,900)
Kostot e huasë	(16,337,879)	(21,495,544)
	(21,894,324)	(32,531,471)
Shpenzime financiare neto	(21,782,046)	(32,229,347)

24. Tatimi mbi fitimin

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	21,220,181	8,263,652
	21,220,181	8,263,652

Shoqëria përcakton tatimin në fund të vitit, sipas legjislacionit tatimor shqiptar. Në vitin 2017, norma e tatimit mbi fitimin në Shqipëri është e barabartë me 15% të rezultatit të tatueshëm (2016: 15%). Në vijim paraqitet një rakordim midis tatimit mbi fitimin të llogaritur me normën e aplikueshme të tatimit dhe shpenzimit të tatimit mbi fitimin:

	<u>2017</u>		<u>2016</u>	
Fitimi para tatimit		38,886,446		26,041,656
Tatimi mbi fitimin me normën prej 15%	15%	5,832,967	15%	3,906,248
Shpenzimet e panjohura	35%	13,632,041	12%	3,006,433
Ndryshimi në diferencat e përkohshme të panjohura	5%	1,755,173	5%	1,350,971
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	55%	21,220,181	32%	8,263,652

Ndryshimi në diferencat e përkohshme të panjohura prej 1,755,173 Lek (2016: 1,350,971 Lek) lidhet me kosto të caktuara të njohura për qëllime kontabël, por jo për qëllime tatimore. Megjithëse këto shpenzime mund të zbriten nga rezultati tatimor në të ardhmen, Shoqëria nuk ka njohur ndonjë aktiv të shtyrë tatimor në lidhje me to sepse rezultati i kësaj çështjeje është i pasigurt, pasi është subjekt vlerësimesh të ardhshme nga autoritetet tatimore.

25. Angazhime dhe detyrime të mundshme*Çështjet ligjore*

Gjatë rrjedhës normale të biznesit, mund të ngrihen padi kundër Shoqërisë. Bazuar në vlerësimet e tij, Drejtimi është i mendimit që nuk do të shkaktohen humbje materiale në lidhje me këto padi përtej provizioneve të paraqitura në këto pasqyra financiare (shih shënimin 16).

Qiratë operationale të paanullueshme

Shoqëria ka hyrë në një kontratë qiraje për zyrat dhe ambientet e saj, të cilat janë të anullueshme pas një njoftimi përkatësisht gjashtëmuor dhe katërmuor. Në 31 dhjetor 2017, pagesat e ardhshme minimale të qirasë për qiratë e paanullueshme ishin 4,998,920 Lek (2016: 4,162,843 Lek).

Detyrimet të mundshme

Kompania ka marrë dy letra garancie nga Societe Generale Albania në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave lidhur me detyrime potenciale të ardhshme ndaj kësaj të fundit me një limit total prej 756,600 mijë Lek (2016: 621,700 mijë Lek). Normat vjetore të interesit pa risk për këto garanci janë 1.2% dhe 1%. Këto garanci do të përdoren në rast se do të lindë një detyrim i ardhshëm. Ato nuk janë përdorur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

British American Tobacco – Albania Shpk**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***26. Transaksionet me palët e lidhura**

Shoqëria mëmë përfundimtare që ka kontrollin mbi Shoqërinë është British American Tobacco plc, me seli në Londër, Mbretëria e Bashkuar. Shoqëria mëmë është British American Tobacco International Holdings B.V. Hollandë.

Transaksionet me palët e lidhura të Shoqërisë janë si më poshtë:

	2017	2016
<i>Të arkëtueshme (Shënimi 11)</i>		
BAT Western Europe Commercial Trading	11,988,362	46,216,852
TDR Dooel Skopje	2,435,921	-
	14,424,283	46,216,852
<i>Të pagueshme tregtare (Shënimi 14):</i>		
BAT Western Europe Commercial Trading	30,318,002	7,933,520
BASS (GSD) Limited	6,502,307	3,078,748
BASS Europe SRL	9,032,025	3,093,665
BAT SEE doo Beograd	-	418,765
BAT Trading Eood Sofia	3,813,958	-
	49,666,292	14,524,698
<i>Hua (Shënimi 17)</i>		
BAT Western Europe Commercial Trading	208,848,505	210,088,863
	208,848,505	210,088,863
<i>Të ardhura (Shënimi 22)</i>		
BAT Western Europe Commercial Trading	40,063,197	49,292,562
BAT SEE doo Beograd	570,504	-
BAT Trading Eood	2,432,439	-
	43,066,140	49,292,562
<i>Shpenzime operative</i>		
Shpenzime për blerjet e cigareve (Shënimi 19)	291,695,028	201,688,735
Shpenzime administrative	81,846,631	75,286,787
Shpenzime konsulence, ligjore dhe trajnimi	3,813,958	-
	377,355,617	276,975,522
<i>Kosto financiare</i>		
BAT Western Europe Commercial Trading	(16,337,879)	(21,495,544)

Transaksione me drejtimin

Drejtuesit kryesorë janë ata persona që kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për planifikim, drejtim dhe kontroll të aktiviteteve të Shoqërisë, drejtpërdrejt ose jo, duke përfshirë Administratorin. Drejtuesit kryesorë kanë marrë pagesat e mëposhtme gjatë vitit, të cilat janë përfshirë në shpenzimet administrative dhe tregtare:

	2017	2016
Shpenzime page dhe shpërblime	3,974,345	4,415,605
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	234,885	221,427
Shpërblime të tjera	-	399,347
	4,209,230	5,036,379

27. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që kërkojnë rregullim apo paraqitje në pasqyrat financiare.